



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 355 Prot.

Tiranë, më 21.05 2015

VENDIM Nr. 32 datë 13.05.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6, të datës 13.05.2015, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Kora antike e Epidamnos Dyrrahionit"*, me një shtrirje 5 vjeçare, paraqitur nga Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore në Universitetin e Tiranës, bashkëdrejtues të tij Prof. dr. Iris Pojani dhe Prof. as. dr. Lorenc Bejko,

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor "Kora antike e Epidamnos Dyrrahionit"*, paraqitur nga Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore në Universitetin e Tiranës, bashkëdrejtues të tij Prof. dr. Iris Pojani dhe Prof. as. dr. Lorenc Bejko.
 - Kryerjen e hulumtimeve arkeologjike, vrojtim sistematik dhe sipërfaqësor, sondazhe, gërmim, në zonën që shtrihet nga grykëderdhja e lumit Mat në Veri të Kepit të Rodonit, deri në grykëderdhjen e lumit Shkumbin në Jug të Kepit të Lagjit (Melisës).
 - Kryerjen e sondazheve në Sitin prehistorik-Kepi i Palit
- II. Proceset e hulumtimit arkeologjik do të kryhen sipas periudhave kohore të parashikuara në projektin e paraqitur.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR

SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: www.asha.gov.al